

NIKOLETA CIKULI

ROLI I SHTYPIT NË NGULITJEN DHE PËRHAPJEN E NORMËS DREJTSHKRIMORE

Drejtshkrimi, i cili ka të bëjë me fjalën e shkruar, nuk është thjesht një problem që u intereson vetëm gjuhëtarëve, por një problem i cili do të përcaktojë vijat themelore për hartimin përfundimtar të drejtshkrimit. Përpyekje të shumta për njësimin e drejtshkrimit janë bërë prej kohësh, por mundësitë u krijuan vetëm pas çlirimit. Drejtshkrimi është nga shenjat e para dhe kryesore që tregon se në ç'gjendje është gjuha e shkruar. Po të bëhet një krahasim midis gjuhës së shkruar të ditëve tona (përsa i përket drejtshkrimit) dhe asaj të viteve të para pas çlirimit, do të vemë re se është ecur mjaft përpara, gjithmonë po shkohet drejt njësimin (sigurisht në asnjë gjuhë dhe asnjëherë s'mund të flitet për njësim të përsosur, përderisa gjuha është kurdoherë në zhvillim e sipër). Dihet se fenomenet varen njëri nga tjetri. Edhe në gjuhësi drejtshkrimi asnjëherë s'mund të merret i shkëputur nga zhvillimi objektiv i gjuhës letrare kombëtare. Sot flasim për drejtshkrim që shkon drejt njësimin, sepse sot «kemi një gjuhë të vetme letrare shqipe, e cila ndodhet në fazën e kristalizimit përfundimtar të normës së saj¹... Pas çlirimit vetë zhvillimi ekonomik, politik dhe kultural i vendit bënë të mundur që të rritet roli i fjalës së shkruar. Veç shkollës, një rol të madh vendimtar dhe aktiv për njësimin e drejtshkrimit ka luajtur shtypi në përgjithësi dhe para së gjithash publicistika që shquhet për masivitetin e saj. Shtypi ynë, pararoja e propagandës së partisë sonë, që dallohet për karakterin popullor dhe principialitetin e lartë, ka marrë një zhvillim të gjerë si në sasi edhe në cilësi. Një prej shprehjeve të këtij ndryshimi cilësor, përsa i përket anës gjuhësore, është kalimi gjithmonë e më tepër në trajta të qëndrueshme drejtshkrimore.

Në vitet e para pas çlirimit, kur populli ishte hedhur i tëri në luftë për rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik e kultural të vendit, u ndje edhe mungesa e një drejtshkrimi. Gjendja në shtyp paraqitet kështu: «Po lëkundet kjo orthografi e jonë në mes shumë fluktuacionesh, saqë çdo shkrimtar a auktor ka një mënyrë më vete orthografie... Veç kësaj dhe çdo shkrimtar ose auktor që thuhet se ka formue një farë mënyre shkrimi, nuk është konsekuent në punë të orthografisë së vet... Kjo punë duket në shkrimet tona të përditëshme si të gazetave e të revistave si edhe të broshuravet e të libravet që janë botuar e botohen kohë mbas kohe. Me pasë kohë njeriu t'i vejë re kësaj pune nëpër gazeta, revista e libra të m-

1) A. Kostallari, *Një hap i ri përpara për njësimin e shqipes letrare*, «Zëri i popullit», 19 mars. 1967.

parshme e të soçme do të mblidhte, jo vetëm nga mbrendija e tyre, por deri nga titujt e tyre, një tok shembullash të tilla ku do të duket një varg i madh fluktuacionesh n'orthografi»². Ka shumë faktorë që e shpjegojnë këtë gjendje: rrethanat politike dhe shoqërore në të cilat jetoi populli ynë para çlirimit nuk ishin të favorshme për zhvillimin e kulturës përgjithësisht dhe të gjuhës letrare veçanërisht. Ekzistonin në gjuhë dy variante kryesore «koineja letrare jugore dhe varianti letrar verior»³.

Me vendosjen e marrëdhënjeve të reja, u krijuan kushtet reale që; lehtësuan procesin e krijimit të gjuhës letrare, edhe procesin e njësimimit të drejtshkrimit (reforma arësimore, fushata për zhdukjen e analfabetizmit, depërtimi në shkallë të gjerë i kulturës në masat, krijimi i institucioneve, shtimi i botimeve, zhvillimi i letërsisë artistike, radioja, teatri etj. rritën rolin e fjalës së shkruar). U botuan tri ortografi (më 1951, 1956, 1967, të cilat, pa dyshim, i dhanë një kontribut të mirë stabilizimit dhe normativizimit të gjuhës sonë letrare dhe drejtshkrimit të saj, por ato do të ngeleshin pa jetë në se nuk bëheshin pronë e shtypit tonë. Del pyetja pse pikërisht shtypi dhe në mënyrë të veçantë publicistikës i bie barra që të ngulitë dhe të përhapë normën drejtshkrimore? Shtypi ynë ka disa veçori, ai dallohet para së gjithash për *karakterin masiv*. Tek ne ai s'është monopol i gazetarëve profesionistë, por është i masave. Mjaft shkrime sot janë të korrespondentëve vullnetarë, të punëtorëve, fshatarëve, ushtarëve etj. Kuptohet se, duke u ushtruar, masa që shkruan, do të bëjë të vetat edhe normat e gjuhës letrare, edhe normat e drejtshkrimit. Shtypi (në kuptimin e gjithë botimeve të përditshme e të përkohshme siç janë gazetat e revistat), ka edhe këtë veçori specifike që e dallon nga botimet e tjera: ai, duke trajtuar probleme aktuale, pasqyron jetën e përditshme, për të cilën interesohen të gjithë; kjo e bën që të ketë një rreth shumë më të gjerë lexuesish se sa letërsia artistike e tekniko-shkencore. Shtypi ndikon në të gjitha moshat. Për një pjesë të popullsisë që nuk ndjek shkollën e kurseve, ai luan rolin kryesor, për ngulitjen e normës drejtshkrimore. Gjatë 28 vjetëve shtypi ynë veç ndryshimeve cilësore ka bërë edhe përparime sasiore. Për këtë mjaftojnë të dhënat e mëposhtme: «Në vitin 1938 dilnin 6 gazeta dhe 15 revista me një tirazh vjetor të përgjithshëm prej 2.670.000 kopjesh. Gazeta më e madhe e regjimit të Zogut «Drita» dilte me tirazh 4000 kopjesh në ditë. Kurse sot vetëm tirazhi ditor i «Zërit të popullit» është 95000 kopje në ditë. Sot në vendin tonë dalin 22 gazeta me një tirazh vjetor prej 4.593.600 kopjesh»⁴ dhe rreth 40 revista. Rritja nga viti në vit e tirazhit është një tregues i qartë që dëshmon se shtypi është bërë i domosdoshëm për këto. Duke qenë me shtrirje aq të gjerë, ai është mjet i përshatshëm edhe për përhapjen, përvetësimin dhe ngulitjen e normës drejtshkrimore. Është për t'u theksuar edhe një cilësi tjetër: shtypi është i pari që vë në përdorim fjalë të reja, shprehje dhe terma të ndryshme; me qindra janë fjalët që shtypi jo vetëm i përdor, por edhe i përsërit shpesh,

2) Referat i shefit të gjuhësisë dhe të letërsisë, prof. A. Xhuvani «Buletini i Institutit të studimeve» nr. 1, 1947, fq. 36.

3) A. Kostallari Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, «Studime filologjike», nr. 2, 1970, fq. 13.

4) Shtypi ynë popullor në jubileun e madh, «Tribuna e gazetarit», nr. 4 1972, fq. 4

pra ai është përçuesi vendimtar dhe luan një rol të veçantë për ngulitjen e drejtshkrimit, përgjegjësia e tij në këto rrethana është shumë e madhe. Këto karakteristika e bëjnë atë mjaft të aftë për të qenë një shkollë e vërtetë ku çdo ditë, kudo dhe prej kujtdo mësohet si të shkruhet gjuha.

Duke u mbështetur në gjendjen e sotme drejtshkrimore të shkrimeve të ndryshme (lutje, vërtetime, letra, lajmërimi, fletërrufe etj.) të njerëzve të moshave dhe të profesioneve të ndryshme, arrijmë një konkluzion të përgjithshëm: njësimi bëhet gjithmonë më i qartë edhe për arsye të ndikimit të shtypit, por për të përcaktuar se në ç'masë dhe si ka ndikuar shtypi, është e nevojshme të bëhen studime të hollësishme.

Organeve tona të shtypit partia u ka shtruar gjithnjë detyrën e ngritjes së shtypit në një shkallë më të lartë jo vetëm nga ana ideologjike dhe shkencore, por edhe nga ana gjuhësore. Kjo detyrë është kuptuar drejt nga të gjitha. Ortografita e gjuhës sonë gjatë evolucionit të tyre kanë kaluar nëpër disa etapa, po në këto etapa ka kaluar edhe shtypi ynë, gjë që provon se ai asnjëherë s'ka qenë indiferent, por përkundrazi ka ndihmuar për njësimin e drejtshkrimit duke e bërë në disa raste të qartë edhe perspektivën e zhvillimit të këtij apo atij fenomeni gjuhësor. Në etapën e parë (1945-1956) ka pasur shumë luhatje. Mjaft fjalë, për arsye të përdorimit paralel të të dy dialekteve, toskërishtes dhe gegërishtes, i gjejmë të shkruara në dy mënyra.

Përmirësime të dukshme vihen re në etapën e dytë (1956-1967). Gjithmonë bëhej më i qartë kristalizimi i gjuhës letrare kombëtare, si rrjedhim edhe kristalizimi i normës drejtshkrimore. Rol të madh luajti ortografia e vitit 1956.

Etapa e tretë (1967 e këtej) ka rëndësi të veçantë për dy arsye: më 1967 u botuan «Rregullat e drejtshkrimit» (projekt) qëllimi i të cilave është të ndihmojnë për njësimin e mëtejshëm të normës letrare kombëtare, po në këtë vit filloi botimi i gazetave lokale. Pesëmbëdhjetë gazeta botohen sot nëpër rrethe të ndryshme të atdheut, ky është një sukses i madh për shtypin tonë. Ato janë mjet i fuqishëm jo vetëm për edukimin dhe mobilizimin e masave për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, por edhe për përhapjen dhe ngulitjen e normës së gjuhës letrare rrjedhimisht dhe të drejtshkrimit të njësuar. Nga vëzhgimet e bëra del kjo e vërtetë: një pjesë e mirë e gazetave lokale, duke vlerësuar drejt rolin e njësimin të drejtshkrimit, e vunë projektin në jetë më përpara se disa organe qëndrore. Në vitet e para (1967-1969) të kësaj etape u shtuan rastet e grafive dymënyrshe. Arsyeja është e qartë: jo të gjitha organet treguan të njëjtin kujdes për «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» (projekt), disa filluan ta zbatojnë menjëherë dhe pothuajse në tërësi, disa me vonesë dhe pjesërisht. Në krahasim me gazetën, revistat po tregohen më të ngathta përsa i përket zbatimit të projektit.

Pjesa më e madhe e çështjeve që trajtohen në «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes», zbatohen në praktikë, por krahas kësaj haset rezistencë për çështje që edhe pse projekti u ka dhënë një farë zgjidhje mbeten ende të diskutueshme⁵.

5) Kemi parasysh përdorimin e ë-së paratheksore dhe pastheksore jofundore, përdorimin e shkronjave të mëdha, takimin e shkronjës g ose n me j-në etj.

Zbatimi i drejtshkrimit në shtypin tonë, i parë në evolucionin e tij 28-vjeçar, ka ecur shumë përpara, por kjo nuk do të thotë se ai u përgjigjet plotësisht të gjitha kërkesave dhe se s'ka lëkundje. Po të vërejmë me kujdes, nëpër faqet e shtypit do të hasim luhatje të tilla p.sh.: e dhe ë njëkohësisht (*vend-vënd*); në shkrimin e *sh/ç* nistore, edhe pse prirja është e qartë (në të mirë të *sh-së*), ende takojmë *shfrytëzim-çfrytëzim*; megjithëse shumë më rrallë se në vitet e mëparshme, gjejmë fjalë të huaja të shkruara në dy mënyra. Ndërsa në shkrimin e fjalëve të prejardhura dhe të përbëra ecet më lehtë drejt njësimi, në shkrimet e lokucioneve ndajfoljeve dhe parafoljore po ashtu edhe në shkrimin e fjalëve me vizë në mes, ende vihet re pasiguri. E ndërlikuar dhe e lëkundur del në shtyp çështja e përdorimit të shkronjave të mëdha në emërtimet e institucioneve, ngjarjeve historike, emërtimeve gjeografike të përbëra etj. Një nga çështjet më delikate dhe të vështira të drejtshkrimit të shqipes mbetet zanorja ë. Është për t'u theksuar se në krahasim me vitet e mëparshme (1949-1967) rrethi i problemeve që lidhen me zanoren ë sa vjen e zvogëlohet; mjaft lëkundje që kishin të bënin me ë-në fundore janë eliminuar për arsye të vetë kristalizimit të gjuhës letrare. Sot lëkundjet kufizohen tek ë-ja pastheksore jofundore dhe tek ë-ja paratheksore.

Në organet që ende s'e vlerësojnë sa duhet drejtshkrimin, vemë re se përdoren trajta të tilla, të cilave u ka kaluar koha si p.sh. *poshtërues, fitues, i math; redaksija, biologjije; lexonja; i zjartë; ç'farë, ç'do* (njeri), *ç'rrënjosje, në'to, t'a marrë* etj. I dhamë këta shembuj jo se gjendja është shqetësuese, por për të theksuar se të gjitha organet, pavarësisht nga profili i tyre, duhet të ecin me kohën, të vlerësojnë njëloj drejtshkrimin.

Ka arsye objektive dhe subjektive që shpjegojnë ekzistencën e këtyre luhatjeve. Edhe sot ka probleme të diskutueshme, të pazgjidhura plotësisht; këto më mirë se kudo reflektohen në shtypin e përditshëm. Disa gazeta e revista, duke i dhënë prioritet përmbajtjes, harrojmë, nënvleftësojnë anën tjetër, paraqitjen drejtshkrimore (nuk mund të shpjegohet ndryshe që në artikuj shkencore tërheqës gjenden me dhjetra gabime ortografike).

Në përgjithësi shtypi i ka kapërcyer lëkundjet dialektore, megjithatë aty-këtu sidomos në gazetatat lokale shfaqen raste të këtyre lëkundjeve. Shtypi sot duhet të përmbushë të gjitha detyrat që i janë ngarkuar, midis të tjerave të mos lejojë asnjë lëkundje të kotë në drejtshkrim, pra ta ngrejë nivelin e drejtshkrimit në përputhje me stadin e sotëm të zhvillimit të gjuhës letrare. Interesimi i masave për shtyp çdo ditë rritet më shumë. Kërkesat nuk mund të jenë dhe nuk mund të krahasohen me ato të viteve të para. Sot lexuesi interesohet më tepër se kurrë edhe për paraqitjen gjuhësore të shkrimeve, edhe për drejtshkrimin, ai të njëjtën fjalë, kudo që ta hasë, duhet ta gjejë të shkruar njëloj.

Kongresi do të përcaktojë përfundimisht rregullat e drejtshkrimit. Duke u nisur nga fakti se trajtat drejtshkrimore të gjuhës së shtypit fitojnë një përhapje të gjërë dhe qëndrueshmëri të madhe, për të vënë në jetë sa më mirë rregullat përfundimtare, është e nevojshme ngritja në një shkallë edhe më të lartë e kulturës gjuhësore të të gjithë punonjësve të shtypit, përvetësimi i ndërjegjshëm i rregullave të drejtshkrimit.

Pavarësisht nga luhatjet që mund të vihen re në shtypin e përdit-

shëm dhe periodik, po të vërejmë evolucionin e tij gjatë periudhës së pasçlirimit, konstatojmë se ai ka ecur gjithnjë me siguri dhe shpejtësi drejt njësimimit të drejtshkrimit dhe ka ushtruar kështu një ndikim të madh për ngulitjen dhe përhapjen e normës drejtshkrimore. Shpesh, kur diskutohet për mënyrën e të shkruarit të ndonjë fjale, si përgjigje më e sigurt dhe e prerë jepet kjo: e shkruaj kështu se kështu e jep edhe shtypi. Kjo tregon që ai ka fituar një autoritet të madh; ky autoritet duhet shfrytëzuar në dobi të njësimimit.

Shtypit tonë, i cili karakterizohet për përmbajtjen thellësisht revolucionare, i bie detyra që në të ardhmen t'i prijë ende më mirë njësimimit të mëtejshëm të drejtshkrimit.

